



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEQA"

TREGJET DHE INSTITUCIONET FINANCIARE

ROLI I INSTITUCIONEVE FINANCIARE DHE I BANKAVE TREGTARE
NË TREGJET FINANCIARE

Kapitulli 3

Ph.D. Fisnik Morina



MARS, 2018



TREGJET DHE INSTITUCIONET FINANCIARE



2

- Lënda: Tregjet dhe Institucionet Financiare
- Viti II-të, Semestri IV, Departamenti: Administrim Biznesi
- Statusi i lëndes: Obligative
- Javët mësimore: 15 (2 orë ligjerata, 2
- Ph.D. Fisnik Morina
- Emaili: fisnik.morina@unhz.eu





ROLI I INSTITUCIONEVE FINANCIARE DHE I BANKAVE TREGTARE NË TREGJET FINANCIARE



3

- Përveç Bankes Qendrore dhe individëve të veçantë ofrues dhe përdorues të fondeve në veprimet e tregjeve financiare marrin pjesë dhe një seri institucionesh të specializuara bankare e financiare, pa të cilat veprimtaria e këtyre tregjeve do të ishte shumë e varfër.
- Të gjitha tregjet financiare shërbejnë si kanale të rëndësishme të kalimit të fondeve tek përdoruesit që kanë nevojë për to.
- Ky kalim mund të kryhet sigurisht edhe me anën e lidhjes direkte të ofruesve dhe të përdoruesve të këtyre fondeve monetare nëpërmjet përdorimit të instrumenteve përkatëse të tregjeve financiare.



ROLI I INSTITUCIONEVE FINANCIARE DHE I BANKAVE TREGTARE NË TREGJET FINANCIARE



4

- Institucionet e ndryshme financiare si pjesëmarrës aktivë në të gjitha veprimet e tregjeve financiare krijojnë të gjitha kushtet e nevojshme për një zhvillim të vrullshëm të të gjitha llojeve të veprimeve që lidhen me kalimin e fondeve nga ofruesit tek përdoruesit e tyre.
- Së pari institucionet financiare sigurojnë mbledhjen e një informacioni sa më të plotë me një kosto më të ulët.
- Së dyti, llojet e ndryshme të institucioneve financiare u sigurojnë ofruesve të fondeve, letra me vlerë me një nivel më të ulët rreziku nga pikëpamja e kthimit të tyre në likuiditete dhe të arkëtimit të plotë të fondeve të investuara.

□ Institucionet financiare

Llojet e Institucioneve financiare për nga Funkzioni i tyre

Institucionet financiare ndërmjetësuese

I. Institucionet Depozituese

1. Bankat Komercale
2. Shoqëritë e kursim- kreditit

II. Institucionet Jo- Depozituese

1. Institucionet e kursimit të kontraktuar:

1. 1. Kompanitë (shoqëritë) e Sigurimeve :

- 1.1.1. Sigurimet Jo- Jetësore
- 1.1.2. Sigurimet Jetësore

1. 2. Fondet e pensioneve:

- Fondet private të pensioneve dhe
- Fondet publike të pensioneve

2. Institucionet Investuese:

- Fondet Investuese
- Kompanitë e Financimit (fondacionet)

Institucionet financiare shërbyese

1. Shtëpitë Brokere
2. Shtëpitë Dilere
3. Bankat Investuese
4. Lehtësuesit financiar
5. Tregjet e Organizuara:
 - Bursat
 - OTC

Përfitimet për ekonominë nga institucionet financiare



6

- Së pari të gjitha IF shërbejnë si hallka shumë të rëndësishme për zbatimin praktik të politikës monetare të Bankes Qendrore për sigurimin e stabilitetit të çmimeve, rritjes ekonomike dhe të punësimit të plotë.
- Së dyti, bankat dhe IF të tjera nëpërmjet studimeve dhe kontrollove të tyre sigurojnë shpërndarjen më optimale të fondeve të kreditit për stimulimin e investimeve.
- Së treti, institucionet e tilla financiare siç janë shoqëritë e sigurimeve dhe fondet pensionale realizojnë transferimin kohor të fondeve.
- Së katërti, IF kryejnë në çdo ekonomi të gjitha llojet e likuidimeve.



Institucionet financiare në tregjet financiare



7

1. Banka tregtare
2. Banka dhe institucione të kursimeve
3. Banka të investimeve
4. Shoqëritë e sigurimeve
5. Shoqëri financiare
6. Fonde të investimeve
7. Fonde të pensioneve



Shërbimet kryesore të institucioneve financiare



8

1. Kryerja e të gjitha llojeve të likuidimeve
2. Pranimi i formave të ndryshme të depozitave bankare
3. Administrimi në mirëbesim i llojeve të ndryshme të pasurisë
4. Akordimi i llojeve të kreditit dhe huave
5. Marrja përsiper garantimin dhe nënshkrimin e letrave me vlerë
6. Kryerja e shërbimeve të ndryshme për sigurimin nga llojet e veçanta të rreziqeve financiare.



Letrat e kreditit



9

- Këto përfaqsojnë garanci që një bankë u jep klientëve të saj në formën e së drejtës të përdorimit të një krediti në favor të furnitorëve të këtij klienti.
- Letra e kreditit e lëshuar për këtë qëllim i drejtohet një banke tjetër së cilës i kërkohet që t'i paguajë furnitorit një shumë të caktuar menjëherë pas plotësimit nga ana e këtij të fundit të të gjitha kushteve të shënuara në letrën në fjalë.
- Letra e kreditit “Stand-by”, këto letra krediti i ngjajnë më tepër një kontrate sigurimi sepse me anë të tyre banka lëshuese merr përsiper të mbulojë nevojat e jashtëzakonshme që mund të lindin në të ardhmen klientit të saj, të cilat mund të mos lidhen vetem me veprimtarinë tregtare.



Letrat e kreditit



10

- **Marrëveshje huadhënie të ardhshme** përfaqsojnë një lloj kontrate me anën e së ciles banka merr përsiper t'i jap në një periudhë të ardhshme klientit të saj një hua deri në një shumë maksimale dhe me një normë të caktuar interesi.
- **Marrëveshje të shitjës së borxheve** nënshkruhen ndërmjet bankave ose ndërmjet bankave dhe IF të tjera dhe me anën e tyre shitësi i kalon palës tjetër për një shumë më të vogël borxhin që i detyrohen të tjerët.
- Në të gjitha rastet e shitjës së borxheve bankat i heqin shumat e tyre nga bilanci dhe i kalojnë si shuma të veprimtarive jashtë bilancit.

Institucionet dhe bankat e kursimeve



11

- Të gjitha institucionet financiare kanë një destinacion të përbashkët, ato janë krijuar për një adiminstrim më të mirë të kursimeve të vogla të individëve dhe për një plotësim më të mirë të nevojave të tyre për hua hipotekore.
- Rregullat konkrete të themelimit dhe të funksionimit të insitucioneve dhe të bankave të kursimit ndryshojnë nga një vend në tjetrin.
- Bankat e kursimit përqendrojnë veprimtarinë e tyre në depozitat afatshkurtër dhe afatgjatë të individëve të shtresave të mesme të popullsisë.

Institucionet dhe bankat e kursimeve



12

- Depozitat e klientëve në bankat e kursimit sigurohen në një mënyrë të caktuar nëpërmjet organizmave të veçantë.
- **Shoqatat e kursimit** – kanë pak a shumë po të njejtat burime dhe përdorime si dhe bankat e kursimit me disa ndryshime përsa i përket peshës specifike të zërave të veçanta të pasiveve dhe aktiveve të tyre, veçanërisht të peshave me të medha specifike të huave të konsumit dhe të huave tregtare.
- **Unionet kreditore** – karakterisitka dalluese e këtyre unioneve është se ato themelohen nga anëtarët e një bashkësie të caktuar, depozitat e të cilëve formojnë dhe kapitalin aksionar të këtyre unioneve.



Shoqëritë e sigurimeve dhe fondet e pensioneve



13

- Shoqëritë e sigurimeve janë institucione që kundrejt një pagese të caktuar në formë primesh sigurimi marrin përsipër mbulimin e disa dëmeve të personave fizikë dhe juridikë, të shkaktuara nga ngjarje e dëmtime të ndryshme që mund të shprehen në formë monetare.
- Të gjitha shoqëritë e sigurimeve mund të klasifikohen sipas dy kriterëve:
 1. Sipas objektit të sigurimit dhe
 2. Sipas karakterit të shoqërive.



Shoqëritë e sigurimeve dhe fondet e pensioneve



14

- Nga pikëpamja e objekteve të sigurimit dallohen: sigurimi i personave dhe sigurimi i sendeve.
- Format tradicionale të sigurimeve të jetës, të cilat mund të bëhen në tre variante e konkretisht në variantin e një date të caktuar sigurimi, në sigurimin gjatë gjithë periudhës së jetës, në sigurimin e jetës të shoqëruar me një fond dëmshperblimi të menjëhershëm, në sigurimin variabël dhe në sigurimin universal të jetës.
- Në sigurimin e jetës deri në një datë të caktuar personi i siguruar i paguan shoqërisë gjatë gjithë periudhës deri në datën e caktuar shumën fikse të primeve vjetore të sigurimit të llogaritur në kontratë.



Shoqëritë e sigurimeve dhe fondet e pensioneve



15

- Në formën e sigurimit gjatë gjithë jetës shoqëria e sigurimeve mbron personin përkatës gjatë gjithë jetës së tij, kurse personi në fjale paguan gjatë gjithë kësaj periudhe një prim sigurimi.
- Në formën e sigurimit të jetës të shoqëruar me një shumë të përnjehershme shpërblimi i siguruari paguan primin e sigurimit gjatë periudhës së parashikuar.
- Forma e sigurimit universal të jetës është një kontratë sigurimi që parashikon nga njëra anë sigurimin e jetës për gjithë periudhen e kontrates dhe nga ana tjetër depozitimin e një shume të caktuar me një rentabilitet të paracaktuar që i jepet të siguruarit në datën e mbarimit të kontratës.



Shoqëritë e sigurimeve dhe fondet e pensioneve



16

- Një peshë të madhe në fushën e sigurimeve zënë shoqëritë e sigurimit të pasurisë nga llojet e ndryshme të rreziqeve.
- Ky sektor i sigurimeve merret me sigurimin e objekteve të pasurisë së personave të ndryshëm fizikë dhe juridikë nga dëmtimet e shkaktuara nga këto rreziqe kryesore: nga rreziku i zjarrit, nga shpërthimet, furtunat, aksidentet e automjeteve, bresheri, vjedhjet etj.
- Personi fizik ose juridik mund të sigurohet kundër një rreziku ose kundër shumë rreziqeve.



Shoqëritë e sigurimeve dhe fondet e pensioneve



17

- Në kohën e sotme kanë marrë një zhvillim të madh sigurimet shoqërore.
- Sigurimet shoqërore realizojnë sigurimin e detyrueshëm të puntorëve, të nëpunësve, të profesionistëve të lirë dhe të disa kategorive të tjera, me qëllim të plotësimit të nevojave të tyre për pensionet e pleqërisë ose të shërbimit për një seri ndihmash financiare.
- Burimet e sigurimeve shoqërore janë kontributet e punonjësve gjatë periudhës së punës së tyre, kontributet e punëdhësve të këtyre punonjësve dhe fondet e buxhetit të shtetit.



Shoqëritë e sigurimeve dhe fondet e pensioneve



18

- Burimet e sigurimeve shoqërore u jepen vetëm për administrim sektorit bankar ose IF të specializuara për administrimin e fondeve në mirëbesim dhe e drejta e pronësisë u mbetet pjesëmarrësve të këtyre fondeve.
- Në përcaktimin e madhësisë së fondit të pensioneve kanë rëndësi disa momente të tjera.
- Së pari, raporti i vendosur ndërmjet kontributeve të derdhura nga punëdhënësit dhe kontributeve të derdhura nga vetë punonjësi.
- Zakonisht ky raport vendoset 4 me 6.



Shoqëritë e sigurimeve dhe fondet e pensioneve



19

- Së dyti, duke qenë se pjesa e kontributeve që derdhet nga paga e punonjësve ashtu edhe pjesa e kontributeve që derdhet nga punëdhënësit zakonisht nuk tatohet, kuptohet se në këtë rast të dy palët kanë një përfitim baraz me normen e tatimit mbi pagat dhe mbi fitimet.
- Përfitimet nga investimi i fondeve të sigurimeve shoqërore varen jo vetëm nga shuma e fondeve të investuara, por dhe nga afati dhe struktura e investimeve të bëra.
- Investimi i fondeve mund të bëhet në letra me vlerë që sigurojnë një rentabilitet vjetor 8% ose në letra me vlerë që sigurojnë një rentabilitet vetëm 4%.



Pjesëmarrës të tjerë të tregjeve financiare



20

- Firmat e tregtimit të letrave me vlerë
- Bankat e investimit
- Fondet e investimit
- Kompanitë financiare



Firmat e tregtimit të letrave me vlerë



21

- Firmat e tregtimit të letrave me vlerë janë institucione financiare që specializohen ose në tregtimin e letrave me vlerë në tregjet financiare sekondare, ose në garantimin e shitjes së letrave me vlerë të emetuara nga të tjerët.
- Në këtë grup të firmave përfshihen pesë kategori firmash:
 1. Filialet e bankave tregtare holding të specializuara si ndërmjetës të tregtimit të letrave me vlerë
 2. Ndërmjetësit e skontimit
 3. Firmat rajonale të tregtimit të letrave me vlerë në rajonet e tyre
 4. Firmat e specializuara për tregtimin elektronik të letrave me vlerë dhe
 5. Firmat e grumbullimit dhe investimit të kapitaleve me rrezik të lartë.



Bankat e investimit



22

- Bankat e investimit janë ato institucione financiare që dallohen nga firmat e letrave me vlerë, nga gjerësia e veprimeve të ndërmjetësimit.
- Ndryshe nga firmat e letrave me vlerë që specializohen ose në tregtimin e letrave me vlerë ose në garantimin e shitjes së tyre, bankat e investimit kryejnë të dyja këto veprime d.m.th janë ndërmjetës me cikël të plotë dhe veprojnë si në tregjet sekondare, ashtu edhe në tregjet primare të letrave me vlerë.



Bankat e investimit



23

- Veprimet më të rëndësishme që kryhen nga bankat e investimit janë:
 1. Veprime investimi në letrat me vlerë
 2. Veprime bankare për garantimin e shitjes së letrave të reja me vlerë të emetuara nga të tjerët.
 3. Veprimet që lidhen me funksionimin normal të tregjeve sekondare të letrave me vlerë dhe të bursave
 4. Veprimet e tregtimit që përfshijnë: veprime të rregullimit të pozicionit, veprime të arbitrazhit neto, arbitrazhit të rrezikut, të tregtimit të programuar, veprime ndërmjetëse dhe veprimet e administrimit të depozitave bankare.



Fondet e investimit



24

- Janë fonde që institucionet financiare të specializuara grumbullojnë nga investitorët e vegjël individualë, të cilët u besojnë kursimet e tyre me shpresë të sigurimit të një rentabiliteti më të lartë se rentabiliteti i formave të ndryshme të depozitave të zakonshme bankare.
- Nga pikëpamja e afatit të investimit të mjeteve, fondet e investimeve ndahen në fonde të investimeve afatshkurtra, të cilat kryejnë investime në letrat me vlerë me afat të vogël se një vit që tregtohen në tregun monetar dhe në fonde të investimeve afatgjata që kryejnë investime në letrat me vlerë me afat mbi një vit në tregun e kapitaleve.



Llojet e fondeve të investimit



25

- Fonde të investimeve me kapital të ndryshueshëm
- Fonde të investimeve me një numër të paracaktuar të njësive
- Fonde të investimeve me ritme të larta rritjeje
- Fonde investimesh të ekuilibruara
- Fonde investimesh të tregut monetar
- Fonde investimesh të obligacioneve
- Fonde investimesh të specializuara
- Fonde investimesh të indeksit
- Fonde investimesh ombrellë
- Fonde investimesh të shoqërive të sigurimit
- Fonde investimesh të një vendi ose të një rajoni
- Fonde investimesh në pasuri të patundeshme



Kompanitë financiare



26

- Kompanitë financiare janë institucione financiare të specializuara për kreditimin e individëve dhe të njësive të vogla të biznesit.
- Këto kompani u sigurojnë individëve të ndryshëm kredi për blerjen e disa mallrave të përdorimit afatgjatë, japin hua hipotekore për strehimin e familjeve dhe hua të ndryshme tregtare njësive të vogla të biznesit.



Kompanitë financiare



27

- Kompanitë financiare dallohen në tri lloje:
 - I. Kompani për mbështetjen e shitjeve me kredi, të cilat kreditojnë blerjen e mallrave të ndryshme të përdorimit afatgjatë, të cilat paguhen me këste.
 - II. Kompani të kreditimit të konsumatorëve individual të specializuara në akordimin e huave hipotekore
 - III. Kompani financiare për kreditimin e biznesit nëpërmjet qiramarrjes financiare (lizingu) dhe të blerjes së borxheve (faktoringu).

Ju Faleminderit për vëmendje !

28

□ SUKSESE !

